

VENDIM
Nr. 385, datë 6.5.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË TË OBJEKTIT “SHKOLLA 8-VJEÇARE PALASË” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 362, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË SË HIMARËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të objektit “Shkolla 8-vjeçare Palasë”, sipas formularit të inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ngritjen e një qendre për të moshuarit.

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Prona, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, i hiqet listës së inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 362, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Himarës”.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
11			Ndërra dhe tuali	Shkolla 8 Vjeçare, Kufi Hirre	1000		Asim 8 vjeçar	Ministria Arsimi	Dr. Arsimi, Vite	Qy shkolle 1 dhe 2 kate dhe siperfaqe funksionale
12			Ndërra dhe tuali	Shkolla 8 Vjeçare, Prizren Bashkia Hirshe Shall	600		Asim 8 vjeçar	Ministria Arsimi	Dr. Arsimi, Vite Bashkia Hirshe Funksion i përbashkët	Ndërra 2 kate dhe siperfaqe funksionale Nuk shkolle me përdorim
13			Ndërra dhe tuali	Shkolla Fillore, L. "Maj", Spile Hirre	100		Asim 4 vjeçar	Ministria Arsimi	Dr. Arsimi, Vite	
14			Ndërra dhe tuali	Shkolla e Mesme, Spile Hirre	1500		Asim i mesëm	Ministria Arsimi	Dr. Arsimi, Vite	
15			Ndërra dhe tuali	Kopësht, Hirre Shall	200		Asim përshkollor	Ministria Arsimi	Dr. Arsimi, Vite	Qy shkolle e ndërra dhe përdorim si shkolle Nuk shkolle me përdorim, zene nga bashkia
16			Ndërra dhe tuali	Kopësht Spile Hirre			Asim përshkollor	Ministria Arsimi	Dr. Arsimi, Vite	Ndërra 2 kate dhe siperfaqe funksionale
17			Ndërra dhe tuali	Shkolla 4 vjeçare Qy shkolle Hirre			Asim 8 vjeçar	Ministria Arsimi	Dr. Arsimi, Vite	Ndërra me 2 kate dhe siperfaqe funksionale